



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Zyra e Prokurimit



K O N T R A T Ë K O R N I Z Ë / F U R N I Z I M / 611-25-1992-5-5-8/C845

Emri i Projektit: **FURNIZIM ME PEME DHE PERIME - 6 MUAJ**

Numri identifikues: **611-25-1992-5-5-8**, Datë: 20.05.2025; Nr. i arkivit: **02-400/03-13459**

PALËT NË MARRËVESHJE

KOMUNA E DRENASIT - DRENAS, përfaqësuar nga **Gentiana Qela**, Zyrtar i Prokurimit (më tutje "Punëdhënësi").

Beni Dona Plast SH.P.K., Ulpiana Tregu i Gjellbërt, PRISHTINË, përfaqësuar nga **Fadil Paqarada**, Drejtor (më tutje kontraktuese).

NENI 1

LIGJI I APLIKUESHËM

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Ligji Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

NENI 2 LËNDA

Lënda e kontratës duhet të jetë: **FURNIZIM ME PEME DHE PERIME - 6 MUAJ**

Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik, duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar.

2.1 Vendi i pranimi të punëve/shërbimeve / furnizimeve do të jetë: Komuna e Drenasit, Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹. Periudha e kryerjes së punëve/shërbimeve dhe furnizimeve do të jetë në afatin prej: **6 Muaj** (Furnizimet kryhen sipas kërkesave të menaxherit).

NENI 3 ÇMIMI

Çmimi i furnizimeve është në shumën prej **5,275.40 €**; me fjalë (Pesë mijë e dyqindë e shtëdhjetë e pesë euro e 40 cent).

3.1 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

3.2 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës.

NENI 4 PAGESAT

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të kryhet kur të raporton Komisioni për pranim, duke mos e tejkaluar shumën prej: **5,275.40 €**;

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme

nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3 Komisionin për pranim i caktojnë Njësit kërkuuese. Afati i kryerjes së punëve/shërbimeve/**furnizimeve** duhet të jetë brenda 5 diteve. Pranimi duhet të kryhet konform neneve të kontratës dhe duhet të jetë konform Pjesës IV, Nenit 81, pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi Prokurim Publik *Ligjit* Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe dokumentacionit dytësor. Monitorimin e kësaj kontrate dhe pjesët e Planit të Menaxhimit e kryen Drejtoria për Shendetesi.

- a) Menaxher apo Mbikqyrës nuk mund të caktohet personi i cili ka marrë pjesë në hartimin e paramasave ose specifikimeve dhe as Ai që ka marrë pjesë në vlerësimin e ofertave. Menaxheri i projektit duhet të veproj konform Udhëzimit A01, përkatësisht Nenit 61.
- b) Të gjitha pagesat kryhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë në Thesar nga Menaxheri apo Zyrtari ndërlidhës. Përqindja % e pagesës, të punëve/shërbimeve dhe **furnizimeve** të kryera do të caktohet nga Drejtoria për Arsim. Poashtu zyrtari ndërlidhës dokumentacionin duhet ta përcjellë për pagesë. Çdo faturë duhet të pranohet nëpërmes arkivit nga Drejtoria për Arsim
- c) Të gjitha dokumentet si: aktvendimet, procesverbalet, raportet për punë/shërbimeve/**furnizime** të kryera, faturat, shkresat, etj. duhet të dorëzohen tek Zyrtari ndërlidhës i Njesise kërkuuese.
- d) Zyrtari ndërlidhës dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimi, urdhërit për pagesë dhe urdhërblertjes, t'i arkivoj dhe ruaj dhe një kopje ti sjellë në ZP. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.

Neni 5

Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6

Kualiteti

6.1 Kualiteti i **furnizimeve**/shërbimeve/punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7

Garancioni i furnizimeve

Nuk aplikohet

Neni 8

Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9

Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10

Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse

nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.


13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në një pajtim me ligjin e Kosovës, **Juridiksioni** do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **Shqipe** në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Pjesë e ofertës është paramasa dhe parallogjaria e ofertuesit. Kontrata hynë në fuqi me **21.05.2025**

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	Gentiana Qela	Emri:	Fadil Paqarada
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	20.05.2025	Data:	20/05/2025
Vula:		Vula:	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Komuna/Opstina/Municipality Drenas(Gllogoc)
Drejtoria Komunale për Arsim



PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Nr.	ARTIKUJT	Buxheti tremujor për Drejtori			Shuma e përafërt
		Njësia matëse	Sasia	Çmimi përafërt	
1	Banane	kg	840	1.50	1260.00
2	Molla	kg	720	0.95	684.00
3	Dardha	kg	720	1.02	734.40
4	Rrush	kg	300	0.90	270.00
5	Pjeshka	kg	300	1.20	360.00
6	Dredhëza	kg	300	2.00	600.00
7	Qershia	kg	300	0.80	240.00
8	Fasulë	kg	160	2.00	320.00
9	Domate	kg	120	1.50	180.00
10	Speca	kg	120	1.60	192.00
11	Tranguj	kg	120	0.99	118.80
12	Laker	kg	192	0.55	105.60
13	Karrota	kg	120	0.60	72.00
14	Patate të reja	kg	300	0.35	105.00
15	Qepë	kg	84	0.40	33.60
					5275.40
	KOMENT: PEMËT VETËM SEZONALE				
	Totali				5275.40

